



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 23 NËNTOR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 23. NOVEMBRA 2018. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projekt-Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat,
5. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit Penal i Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/26 për trashëgiminë në Kosovë,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore,
12. Interpelanca e Ministrisë të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skender Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
17. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,
18. Përzgjedhja e një (1) anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

## **Dnevni red**

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Drugo razmatranje Nacrta - poslovnika Skupštine Republike Kosova,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o sudovima,
5. Drugo razmatranje Nacrta krivičnog zakonita Republike Kosova,
6. Drugo razmatranje Nacrta zakona o disciplinskoj odgovornosti sudija i tužioca,
7. Drugo razmatranje Nacrt zakona o zaštiti uzbunjivača,
8. Drugo razmatranje Nacrt zakona o proširenom nadležnostima o konfiskovanoj imovini,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona za Sudski Savet Kosova,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br. 2004/26 o nasleđivanju na Kosovu,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-007 o vanparničnom postupku,
12. Interpelacija Ministra za rad i socijalna pitanja Skender Recica, na zahtev poslanika Faton Topalli, podržan od 11 poslanika PG PSD, u vezi smrti i povreda radnika na radnim mestima,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o peticijama,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona za zaštiti od buke,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o uspostavljanju nacionalne infrastrukture za prostornu informaciju u Republici Kosovo,
16. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br.05/L-010 o Kosovskoj Agenciji za uporedjivanje i verifikaciju imovine,
17. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za člana Nezavisnog nadzornog saveta civilne službe Kosova,
18. Izbor (1) jednog člana Odbora Radiotelevizije Kosova.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 19 nëntor 2018.

Është kërkuar një mocion procedural për t'i kaluar disa pika të rendit të ditës nga grupet parlamentare. Pikën e parë, të dytën, të tretën t'i evitojmë e të shkohet drejt në votim, mocion procedural. Po shkoj me rend te grupet parlamentare të marr mendimin e tyre, në fund e votoni ju, doni të flisni apo të shkojmë në votim drejt?

A ka mundësi një votim vetëm për prezencë, ju kisha lutur, në mënyrë elektronike, votoni tash vetëm për praninë.

69 deputetë janë në sallë.

Unë po e paraqes mocionin procedural, çdo grup parlamentar e paraqet qëndrimin, në fund e votoni, 69 deputetë.

Avdullah Hoti, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Në përputhje me qëndrimin tonë si grup parlamentar që votojmë marrëveshje ndërkombëtare dhe ligje që lidhen me Agjendën e Reformave Evropiane, ne kërkojmë që të kalojmë menjëherë te votimi i ligjeve prej pikës 3 deri te pika 11, që lidhen me këtë agjendë të integritimeve evropiane. Faleminderit!

KRYETARI: Nga pika 4, më duket. Memli Krasniqi, në emër të PDK-së.

MEMLI KRASNIQI: Edhe ne jemi në favor të këtij mocioni që të kalojmë menjëherë te votimi i projektligjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosjes mbështet mocionin procedural.

KRYETARI: Në emër të Partisë Social Demokrate, Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Edhe në emër të Partisë Social Demokrate mbështesim këtë mocion procedural.

KRYETARI: Ahmet Isufi, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

AHMET ISUFI: E përkrahim.

KRYETARI: Bilall Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

Nëse më lejon, para se të deklarojmë për këtë mocion, desha të them se edhe unë do të kisha pasur dëshirë që të më jepet mundësia të shtroj një mocion procedural, qoftë pasi të votohet kjo, qoftë tash menjëherë, si do që të mendoni që është e udhës.

Unë gjithsesi që pajtohem që ato pika të rendit të ditës të largohen për sot dhe të kalojmë te këto ligje, po qoftë para ligjeve, qoftë pas ligjeve do të kisha pasur dëshirë që përmes një mocioni procedural të kërkoj të futet në rend të ditës një pikë ku Kuvendi do të lëshojë një deklaratë të përbashkët lidhur me zhvillimet e fundit në vend, sepse të gjithë kanë mendim rreth zhvillimeve të fundit, vetëm Kuvendi i Kosovës nuk ka. Nuk dua të paragjykoj se cila do të jetë deklarata, por mendoj që do të ishte mirë që grupet parlamentare të mblidhen, përfaqësuesit e tyre apo kryetarët e grupeve dhe të bëjnë një deklaratë të përbashkët.

Unë kam një draft timin, por nuk do ta prezantoj këtu që të mos dal i njëanshëm, por do të dëshiroja që një deklaratë e tillë të dalë si një deklaratë e përbashkët e të gjitha grupeve parlamentare. Faleminderit!

KRYETARI: Jemi duke folur për pikën e dymbëdhjetë. Në qoftë se propozimi i kryetarit të Grupit Parlamentar Nisma Socialdemokrate që të futet një mocion procedural për një pikë të përbashkët si deklaratë e Kuvendit për zhvillimet e fundit, do ta mbaj dy pjesë në votim.

Po shkojmë te 6+, kisha pasur dëshirë të më jepni përgjigje edhe për propozimin e Bilall Sherifit.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe ne e përkrahim mocionin procedural, gjegjësisht të fillojmë nga pika e katërt e rendit të ditës me shqyrtimin e projektligjeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, po e votojmë mocionin procedural për evitimin e tri pikave të para të rendit të ditës, pikës 1, 2 dhe 3. Votojmë tash!

Kaloi mocioni procedural me 72 vota.

Atëherë, pa i marrë deklaratimet e grupeve parlamentare, propozimin e Bilall Sherifit a e vëmë në votim, a po doni të flisni. Urdhëro, Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Në parim, ne mund të pajtohemi që në Kuvend të nxjerrim një deklaratë të tillë, po zoti Sherifi besoj duhet ta specifikojë kërkesën e tij për të cilat zhvillime do të diskutojmë, cili është propozimi i tij, tekstin e deklaratës, pra i bie që ne duhet të organizojmë një debat për të këtë çështje për të ardhur me një përfundim të caktuar për të nxjerrë një deklaratë. Kështu që nuk besoj që jemi në atë pikë tash. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Besoj se deklarata pastaj do të jetë e grupit të përbashkët të grupeve parlamentare, kështu ishte ideja. Zoti Sherifi, specifikojë pasi ka kërkesë.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mund ta lexoj draftin dhe përmes leximit të saj do të specifikojë pastaj ideja për të cilën kërkoi zoti Hoti.

Nëse më lejoni, nëse është e lejueshme në momentin kur kërkohet një mocion procedural, unë do ta lexoj, ajo do të duket përafërsisht kështu, po jemi të hapur pastaj që të gjithë së bashku ta përpilojmë.

Deklaratë e përbashkët e deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Për shkak të minimumit të vazhdueshëm të sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës nga ana e Serbisë, mbështetjes së forcave që cenojnë sigurinë e vendit tonë, mosrespektimit të marrëveshjeve të nënshkruara në Bruksel dhe detyrimeve ndërkombëtare në raport me Kosovën, si dhe agresioni diplomatik i saj për zhbërjen e pavarësisë së vendit tonë, Qeveria e Kosovës u detyrua të përdorë masa adekuate me qëllim që t'i jepet fund mosndëshkimit të kësaj politike.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për të vendosur taksën prej 100% për produktet e Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, si zbatuese e politikave të Serbisë ndaj Kosovës, është vendimi i drejtë dhe gëzon mbështetjen e plotë të Kuvendit të Kosovës.

Kuvendi i Kosovës konsideron se deri te një vendim i tillë kemi ardhur për shkak të indiferencës edhe të institucioneve ndërkombëtare karshi ankesave të përhershme të Kosovës për politikën shkatërruese të Serbisë.

Prandaj, Kuvendi i Kosovës i konsideron të papranueshme presionet e brendshme apo ato të jashtme për heqjen e këtyre masave.

Deputetët e Kuvendit të Kosovës qëndrojnë fuqishëm në përkrahjen e këtyre masave dhe ftojnë të gjitha bizneset e vendit dhe qytetarët e Kosovës që së bashku të dëshmojnë përgjegjësitë tona në përputhje me situatën e krijuar.

Ky ishte drafti, të cilën e kemi përgatitur në emër të Nismës, shpresoj të gjejmë mirëkuptim dhe ta fusim në rend të ditës, pastaj sigurisht që jemi të hapur qoftë për të shtuar, qoftë për të hequr pjesë, të cilat grupet e tjera parlamentare e konsiderojnë që për t'u bërë edhe e tyre, diçka duhet të hiqet apo të shtohet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Të mos e komplikojmë, të shkojmë në votim, a doni ta futim në rend të ditës këtë deklaratë.

Shkojmë në votim si pikën e rendit të ditës 12, si doni, e vendosni, po nuk doni, pastaj kemi të bëjmë me harmonizim, si mocion procedural është në votim. Votojmë tash!

Faleminderit, ky është rezultati. Nuk futet si pikë e rendit të ditës.

Vazhdojmë në bazë të rendit të ditës që e përcaktoi seanca nëpërmjet mocionit procedural.

#### **4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjykatat**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka konstatuar se amendamenti 8, 11a, 19, 21, 36, 42b dhe 48 përbëjnë kosto shtesë financiare.

S'ka nevojë askush, a të shkojmë drejt në amendamente. Po dëshiron, fjala është për ju. Zonja kryetare e Komisionit Funkcional, Albulena Haxhiu, fjala për ju.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Besoj që duhet të adresohen disa çështje.

E para, është që ky projektligj përmban 50 amendamente.

E dyta, janë disa amendamente që nuk e kanë përkrahjen e komisionit dhe natyrisht duhet të kemi diskutime, në qoftë se propozuesit e amendamenteve dëshirojnë t'i prezantojnë ato. Por, vetëm po e marr përsipër të theksoj një ndryshim që është shumë i rëndësishëm dhe që adreson Projektligji për gjykatat, e që është krijimi i departamentit special në kuadër të Gjykatës Themelore që do të merret me lëndët e Prokurorisë Speciale. Unë besoj që kjo është shumë e mirë, për shkak se sot kemi një prokurori speciale, por që nuk e kemi një Gjykatë Speciale, në fakt po flas Gjykatë Speciale, jo për atë që e ka krijuar ky Kuvend, atë të padrejtën që do ta

gjykojë UÇK-në, por megjithatë për lëndët që janë kompetencë e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.

Në këtë drejtim duhet theksuar faktin që pjesë e grupit punues ka qenë deputeti Korab Sejdiu, që e ka kryesuar këtë grup punues dhe ka qenë një kontribut i jashtëzakonshëm, prandaj edhe projektligji me amendamentet që i ka propozuar Komisioni për Legjislacion duhet të përkrahet.

Në emër të komisionit thërres që të përkrahen amendamentet që e kanë përkrahjen e komisionit. Ndërsa te amendamentet 11, 12, 34, 38 dhe 42 duhet të ndalemi specifikisht. Pra, nëse jeni dakord, ato që e kanë përkrahjen e komisionit të votohen në pako, ndërsa të tjerat veç e veç. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë do të mundohem t'i lexoj, kisha pasur dëshirë për vëmendje, do t'i lexoj një mori amendamentesh, të cilat synoj t'i nxjerr të gjitha në votim të përbashkët.

Amendamentet 1, 2, 3, 5, 6, 13, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 43, 44, 46, 47, 48, 49 dhe 50 e kanë përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Krejt janë në pako, edhe numër 4 është propozim i deputetit, po edhe ky qenka me përkrahje. Në qoftë se dëshironi, me përkrahjen e Komisionit Funkcional edhe numër 4 atëherë. Edhe 7 qenka, atëherë të mos i ngatërrojmë, këto që i përmenda dhe ato të tjerat. Urdhëro, veç thashë të mos i bëjmë dyfish.

ALBULENA HAXHIU: Unë isha shumë e qartë, ngatërresën po e bëni ju, për shkak se unë thashë, të gjitha amendamentet që e kanë përkrahjen e komisionit të votohen në pako, ndërsa të tjerat të votohen veç e veç. E përmenda cilat janë ato që duhet të votohen veç e veç. Amendamenti 11, 12, 34, 38 dhe 42. Pra, këto duhet të votohen veç e veç, jo në kuadër të pakos, nuk po di më e qartë s'mund të jem.

KRYETARI: A ka vërejtje? Urdhëro, Hajdar Beqa! Po e shoh se nuk ka unitet.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë deputetët, ministrat dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Projektligji numër 06/L-054 për gjykatat është një projektligj shumë i rëndësishëm për kuadrin ligjor të Republikës së Kosovës, respektivisht për reformën e drejtësisë.

Ne kemi punuar edhe në grupe punuese, po edhe në komision, ne kryesisht pajtohemi me atë çka tha kryetarja e komisionit, propozojmë që përveç amendamentit numër 22, të gjitha amendamentet e tjera të dalin në votim, cilat e kanë pasur përkrahjen e komisionit.



Kurse amendamenti 22 të dalë i vetëm në votim. Arsyeja pse them që të dalë i veçantë amendamenti 22 që ka të bëjë me fshirjen e paragrafit 2 të nenit 21, përkatësisht çështjes së Divizionit të Apelit në Mitrovicën e veriut, kjo ka të bëjë me një marrëveshje ndërkombëtare që u votua me 2/3 e deputetëve të Kuvendit të republikës së Kosovës, edhe nëse nuk e shtimë në kuadër ligjor aty, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka marrë obligim ndërkombëtar që ta krijojë këtë departament. Unë desha që në konsultim edhe me të tjerët që ky amendament të dalë veç, kurse të gjitha amendamentet e tjera, siç tha edhe kryetarja e komisionit, përveç amendamentit 22, në votim të dalin në pako. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë nuk ka unanimitet, po e shoh. A ka mundësi të më lejoni edhe një herë mua, apo të shkojmë një nga një. Ju lutem, për vëmendje!

1, 2, 3, 5, 6, 13, 19, 20, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 32, 33, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 43, 44, 46, 47, 48, 49, 50 janë krejt propozime të Komisionit FunkSIONAL, t'i heqim këto një herë, pastaj ndalim në të tjerat. Vetëm këto janë propozime të Komisionit FunkSIONAL. Administrata, si e ka bërë, i ka marrë teknikisht, s'ka kurrfarë qëndrimi politik këtu.

A shkojmë një herë në këto të gjitha?

Përgatitemi vetëm për këto, kush është kundër? A ka abstenim?

Shkojmë me elektronikë, këto amendamente, përgatitemi për votim, amendamentet të cilat i përmenda. Shkojnë në votim, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash:

75 deputetë kanë votuar, 75 për, kalojnë të gjitha këto amendamente.

Tani edhe administrata, edhe deputetët, në qoftë se shikojnë ndonjë lëvizje në renditje, është i mirëpritur reagimi juaj.

Jemi në amendamentin 4. Propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

A shkojmë me votim elektronik apo doni me dorë? Elektronik.

Votoni në mënyrë elektronike, tash:

71 deputetë kanë votuar, 61 për, 7 kundër dhe 3 abstenime. Kalon amendamenti.

Ju lutem për vëmendje!

Amendamenti 7. Propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 8. Propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 9. Propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 10. Propozim i deputetit Korab Sejdiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

A ka mundësi të gjithat përnjëherë në mënyrë elektronike?

Votojmë tash për këto amendamente:

71 deputetë kanë votuar, 69 për, 1 kundër dhe 1 abstenim. Kalojnë amendamentet 7, 8, 9, 10.

Amendamenti 11. I kemi dy propozime:

Votojmë në rend të parë propozimin e Komisionit FunkSIONAL, variantin a.

Votojmë tash, në mënyrë elektronike:

73 deputetë kanë votuar, 73 për.

Varianti b, propozimi i Grupit Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Votoni në mënyrë elektronike, ju lutem, është procedurë, përndryshe na kthehet, më mirë votoni, votoni, ju lutem!

68 deputetë kanë votuar, 3 për, 65 janë kundër. Kalon varianti a.

Ju duket pak e mundimshme, procedurat janë të tilla, të mos bëjmë shkelje të na kthehen edhe një herë. Ju kisha lutur për durim. Do të thotë, kalon amendamenti 11, i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 12. Kemi tri propozime, a ka mundësi t'i votojmë me dorë, se tri herë shumë gjatë shkon, me dorë. Sa deputetë janë në sallë, 76.

Po shkojmë me propozimin e parë, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? Abstenim? Të gjithë për, 76.

Propozimi b. Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. A ka dikush për? Abstenim? Të gjithë kundër. 76 kundër.

Propozimi i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Abstenim? Të gjithë janë kundër. 76 deputetë. Kalon amendamenti 12, propozimi a.

Amendamenti 14. Korab Sejdiu, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 15. Po ashtu.

Amendamenti 16. Po ashtu.

Amendamentet 17 dhe 18, të gjitha janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, propozime të deputetit Korab Sejdiu.

Votojmë në mënyrë elektronike, ju lutem! Votojmë tash!

75 deputetë kanë votuar, 73 për, 1 kundër dhe 1 abstenim. Kalojnë këto amendamente.

Amendamenti 22. Propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

Amendamenti 22, votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, 43 për, 16 kundër dhe 6 abstenime. Ju vetë keni votuar. Të keni parasysh, votimi është juaji, s'është diçka çka e kam vënë unë, edhe të ishte për a kundër, po të ishte kundër, Albulena edhe një herë kishte kërkuar gjithsesi të votohet, është rregull, jo s'mund të kthehet, është votuar, s'mund të kthehet.

Shkojmë tutje.

Amendamenti 31. Propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

A është dikush kundër amendamentit 31, të Hajdar Beqës. Kush do të flasë, vetëm pak. Urdhëro, zonja Teutë, fol, në qoftë se ke për amendament diçka.

TEUTA HAXHIU: Kryetar!

Bash për amendament kam.

Po, shumë mirë, të gjitha amendamentet, edhe pse ishin të Hajdarit e të Albulenës, i përkraha edhe unë si deputete e këtij Parlamentit, po sinqerisht, absolut një grimë etike nuk është.

Duke qenë kryetare e komisionit, duke qenë nënkryetarë të komisionit, të gjitha komisionet që tri mandate që bëjnë amendamente, nëse janë me përkrahje të komisionit hyjnë në ligj, nuk ka nevojë të përmendet emri. Sa për televizion, okej, përmendni emrin.

KRYETARI: Shkojmë tutje, të lutem! Replikë, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Veç t'ia shpjegoj disa rregulla procedurale zonjës Haxhiu.

E para, secili projektligj që kalon në parim, brenda afatit dy javë secili deputet, secili grup parlamentar ka të drejtën e propozimeve të amendamenteve.

Në momentin kur nuk protokollohen amendamentet brenda afatit dyjavor, nëse grupi punues nuk i përkrah propozimet, ato nuk mund të vijnë në seancë, sepse nuk protokollohen. Pra, kjo është e drejtë e secilit deputet, të mos na moralizojë e të mos na tregojë rregullat e Rregullores zonja Haxhiu këtu.

KRYETARI: Kundër-replikë, dhe shkojmë tutje, ju lutem!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Fjala që e tha Albulena është për deputetët jashtë komisionit që e kryeson Albulena, kjo është praktikë, absolutisht mos na moralizo, se as s'mund ta na e mbushësh mendjen.

Pra, për të gjithë deputetët që nuk e kanë të qartë si Albulena, ne mund të vazhdojmë edhe kështu, por të gjitha komisionet parlamentare, të gjitha komisionet, pra, amendamentet me përkrahje të komisionit, ti bisedon me deputetët, e merr përkrahjen e anëtarëve dhe njëkohësisht shkruhen në projektligj, por deputetët e tjerë jashtë atij komisioni mund të bëjnë amendamente në atë afat kohor, e nderuar zonja Albulenë.

KRYETARI: Amendamenti 31 dhe 45. Propozimet e Hajdar Beqës, ju lutem, për koncentrim, janë të dyja me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, 31 dhe 45, votoni tash:

Ndale votimin, regjia, të lutem, ndale!

Ju kisha lutur, edhe po më reagoni rëndë, unë të gjithëve ju kam mësues, po koncentrohuni, amendamenti 31 dhe 45, jam duke i lexuar qartësisht. Koncentrohuni, i votojmë bashkërisht, janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar, 67 janë për Hajdarin, veç 2 janë kundër.

Amendamenti 34. Janë dy propozime: Një është me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.  
Po shkojmë me dorë, pasi qenkan dy.

Edhe varianti b është propozim i Listës serbe.  
Votojmë për Komisionin FunkSIONAL, amendamenti 34.  
Kush është kundër?

76 deputetë janë në sallë, a ka abstenim. 76 deputetë për.

Propozimi i Grupit Parlamentar të Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. A ka dikush për? Abstenim? 76 kundër.  
Kalon variacioni a, i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 38. Të njëjtë kohë i kemi dy propozime.  
Komisioni FunkSIONAL, kush është kundër? Varianti a.

A ka abstenim? 76 deputetë janë për.

Propozimi i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Një është për, dy, tre, katër. Abstenim? Nuk ka. Të gjithë janë kundër. 72 kundër.  
Kalon variacioni a, i Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 42. Dy propozime. I Komisionit FunkSIONAL. Kush është kundër? Abstenim.  
Kundër 1. Abstenim? 75 për.

Propozimi i deputetes Fitore Pacolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Po duket çudi pse s'po i përkrahim amendamentet e deputetes Pacolli, sepse komisioni ka arritur të gjejë një konsensus dhe zonja Pacolli është tërhequr, nuk e di nëse e ka bërë zyrtarisht, por të paktën në grup parlamentar ka thënë që është tërhequr. Prandaj edhe amendamenti në fjalë, ajo është tërhequr dhe ne e përkrahim të Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kjo disiplina partiake.  
Atëherë, kështu, a e largoj këtë propozimin b, e kalojmë veç a, të mos shkojmë hiq. 42-shin.

Komisioni FunkSIONAL, të gjithë jemi për, janë 76.

Variacioni i propozimit të deputetes Vitore Pacolli u tërhoq.

Këto janë amendamentet që kaluan deri në 50.

Ta votojmë, ju lutem!

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

74 deputetë kanë votuar. 74 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-054 për gjykatat.

## **5. Shqyrtimi i dytë i Projekt-kodit Penal të Republikës së Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projekt-kodin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Në këtë Projekt-kod janë 77 amendamente. Unë do t'i kisha vendosur në votim të gjitha që janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional, po, në qoftë se do, po. Urdhëro, kryetare e komisionit, fjala për ju.

ALBULENA HAXHIU: Rregullorja e përcakton që kryetarët vetë apo kryetarët e komisionit e prezantojnë në mungesë të tyre zëvendësit, prandaj edhe e kam këtë të drejtë. Këtu janë shumë amendamente dhe është bërë kështu rregull që Komisioni për Legjislacion bën shumë amendamente, po problemi nuk është te komisioni, po te ministria, për shkak të mungesës së cilësisë së projektligjeve.

Prandaj, edhe një herë në emër të Komisionit për Legjislacion unë ftoj që të përkrahen amendamentet që e kanë përkrahjen e komisionit, ndërsa ka edhe shumë amendamente, të cilat nuk e kanë përkrahjen e komisionit, ka amendamente që janë me dy propozime. Prandaj, ato duhet, sikurse edhe te projektligji tjetër, të votohen veçmas. Vetëm dua të shtoj një gjë që është e rëndësishme, këtu është amendamenti 71, në fakt dy amendamente, edhe 72, që i ka adresuar edhe Grupi Punues, gjegjësisht Komisioni për Legjislacion dhe janë dy vepra të reja që janë shumë të rëndësishme, e që njëra prej këtyre është 'mashtrimi' në Prokurimin Publik, që është vepër e re dhe unë besoj që tani nuk mund të ankohen që nuk specifikohen veprat e 'mashtimit' në prokurimin publik, në institucionet e drejtësisë. Dhe, e dyta është ndalimi i hakmarrjes ndaj personave ose sinjalizueseve, personave të cilët raportojnë shkeljet përbrenda institucioneve. Ky ligj i mbron ata, ky kod i mbron ata, për shkak se, në qoftë se punëdhënësit do t'u hakmerren atyre personave, natyrisht që pastaj është paraparë vepra penale për këtë çështje. Prandaj, unë edhe një herë ftoj që të përkrahen amendamentet e komisionit dhe të tjerat do t'i arsyetojnë deputetët që janë në seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, unë do të kisha dëshiruar vëmendjen tuaj. Amendamentet 1 deri në 10, 12 deri 20, vëmendje, 22, prej 24 deri në 32, prej 39 deri në 44, 46, 47, 48, 52, 57, 59, 60, 62, prej 64 deri 70 dhe prej 72 deri 77 janë propozuar nga Komisioni FunkSIONAL. Në qoftë se jemi të pajtimit, i votojmë në mënyrë elektronike të gjitha bashkë. Përgatitemi për votim, i votojmë këto amendamentet që janë nga Komisioni FunkSIONAL tash.

72 deputetë kanë votuar. 72 për. Amendamentet e propozuara kalojnë të gjitha. Kisha kërkuar vëmendje, amendamenti 11, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Amendamentet 71 dhe 72, po ashtu me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. I votojmë të tria bashkë. Votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar. 59 për, 3 kundër, 6 abstenime. Kalojnë këto tri amendamente.

Ju lutem për vëmendje!

Amendamentet 21, 23 janë propozim i Grupit Parlamentar të Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. 28, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 49, vëmendje, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 58, 61, 63 janë të gjitha amendamentet e propozuara nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Ta keni parasysh, Lista serbe gjithmonë ka kërkuar bashkë t'i votojmë, s'ka as në këtë rast përjashtim. Votoni në mënyrë elektronike, janë propozime të Grupit Parlamentar të Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

73 deputetë kanë votuar, veç 1 për. 71 kundër. 1 abstenim. Nuk kalojnë!

Kemi edhe një amendament të propozuar nga Komisioni FunkSIONAL dhe nga Grupi i Grave Deputete, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, vëmendje, i vë në votim të dyja ndaras, në mënyrë elektronike, pasi është veç një. Amendamenti 45, tani e votojmë propozimin e Komisionit FunkSIONAL, a, votoni tash!

63 deputetë kanë votuar. 57 për, 3 kundër, 3 abstenime, i mbajmë në mend.

Tani, propozimi i Grupit të Grave, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash! Urdhëro, zonja Teuta Haxhiu po dëshiron ta ketë fjalën për këtë amendament. Urdhëro, zonja Teutë!

TEUTA HAXHIU: I ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta përkrahin këtë amendament.

KRYETARI: Urdhëro, zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë besoj që zoti Beqa do të na ndihmojë po ashtu në këtë drejtim. Pyetja e parë që e kam bërë kur i kemi shqyrtuar këto amendamente ka qenë: “A jeni konsultuar me Grupin e Grave?” Anëtarët e komisionit, gjegjësisht zoti Beqa dhe zoti Krasniqi, Frashër Krasniqi, më kanë thënë që jemi konsultuar, ato kanë qenë pjesë e amendamentimit, tash që është version i komisionit. Pra, kanë kontribuar edhe ato të shkojë versioni i komisionit, prandaj nëse s’është kështu, atëherë paska pasur mashtrim dhe në këtë drejtim ftoj anëtarët e Bordit të Grave Deputete që, në qoftë se nuk janë konsultuar, atëherë kjo duhet të rikthehet edhe një herë në procedurë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim, përgatitemi për votim, propozimi b, propozim i Grupit të Grave Deputete, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votoni në mënyrë elektronike tash!

Do ta votojmë edhe një herë, nuk kemi numër të deputetëve, edhe një herë ju kisha lutur. Propozim i Grupit të Grave Deputete, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, ju lutem, votoni mbi 61. Në fund të fundit e kemi një vendimmarrje. Votojmë, mos na vononi, votoni tash këtë me propozimin e Grupit të Grave, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 45, votoni tash.

Në qoftë se ka mundësi Komisioni FunkSIONAL, mos na vononi, lexojeni çka të votohet. Cili po e doni, njëri, s’munden të dytë? Albulena Haxhiu, urdhëro, komisioni e ka vendosur dhe shkojmë në votim.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë e sqarova, neve na është thënë që amendamenti 1, versioni i parë i komisionit ka qenë në konsultim me Grupin e Grave. Rrjedhimisht presim që Grupi i Grave ta tërheqë amendamentin e vet. Në qoftë se zonja Haxhiu po thotë që nuk është kështu, e cila është anëtare e Bordit, me sa e di, atëherë nuk qenka e vërtetë ajo që është thënë brenda Grupit Punues. Prandaj, nuk mund të votohet për sa kohë nuk ka qartësime, e ftoj edhe zotin Beqa, le ta japë kontributin, sepse ka qenë kryesues i Grupit Punues për Kodin Penal.

KRYETARI: Armendi, po e vërej reagimin. Armend, ndoshta na e qartëson, urdhëro! Po shkojmë në votim, ju lutem!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Kërkoj falje, a bën veç pak vëmendje! E para, proceduralisht si amendament është gabim, sepse brenda amendamentit është i ndërtuar gabimisht. Parimisht unë jam për, nëse mbetet paragrafi i parë, por këtu thotë ose përkufizimi, sipas “konventës”, që e fut në thonjëza. Kemi dy lloje të amendamenteve brenda një amendamenti, nuk e di administrata se si e ka lejuar, e para dhe, e dyta thotë “po markoj pjesët që janë hequr apo ndryshuar”. Deputetët nuk e dinë cila pjesë është



hequr, cila pjesë është ndryshuar dhe cili përkufizim votohet këtu. Këtë duhet ta sqarojë komisioni, sepse ne jemi vënë në lajthitje se për çka po bëhet fjalë. Parimisht si amendament është mirë i ndërtuar, e mbron dhunën në familje, e dënon faktikisht, dhe nuk ka askush kundër që të votohet nëse nuk është pjesë e Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kështu që e kisha lutur edhe administratën, por edhe njëherësh edhe komisionin që ta sqarojë se për cilin përkufizim deputetët duhet të votojnë, për pjesën e parë apo për pjesën e dytë. Pjesa e parë e parafrazon amendamentin, pjesa e dytë konventën.

**KRYETARI:** Faleminderit! Duhet ta dimë, se po vjen reagimi më herët i deputetëve. 57 deputetë e kanë votuar variantin a, për ta kaluar ky amendament, duhen minimum 61 vota, 58 deputetë për, ta keni parasysh. Nuk kalon lehtë, përgatituni për votim, po shkojmë në votim e të mos e maltretojmë vetveten, por 58 deputetë duhet të jenë për. Votojmë tash!

Votoni, ju lutem!

*(Ndërhyrje)*

Unë do ta them publikisht, kjo më tepër është mospërgatitje për seancë, pastaj është maltretim, në seancë tentohet të kryhet puna, e cila do të duhej të ishte kryer në komision. Ky është qëndrim politik, ku kisha lutur, deputetë, ose votoni për, ose kundër, por mos e bllokoni seancën pa pasur fare nevojë. Tani po doni ta lexoni, e keni pasur që 2-3 muaj e s'e keni shikuar fare. Tash po mundoheni të qartësoni çka po ndodh këtu, janë gjashtë vetë. Shkojmë në tjetrin projektligj në shqyrtimin e dytë, kthehemi edhe një herë pastaj.

*(Ndërhyrje)*

Vetëm pak, është pak e dhimbshme kjo pyetje, kryetar, për faktin se nuk mund të kalojnë të dyja, kur njëra e ka një më shumë, ajo kalon. Unë isha shumë i qartë, Pritni vetëm pak, 57 deputetë kanë votuar për amendamentin a, duhet të votojnë 61 deputetë. Nëse 58 deputetë votojnë për, kalon varianti b, në qoftë se kalojnë 56 për e 5 kundër, kalon varianti a. Është shumë e qartë Rregullorja, nënkryetarja e ka fjalën, Aida Dërguti, po e komplikoni pa nevojë. Urdhëro!

**AIDA DËRGUTI:** Faleminderit, kryetar!

Nuk është ky komplikim yni, por është komplikim prej anës së komisionit. Duhet sqaruar në fillim, para se të hedhet në votim, propozimi i Grupit të Grave Deputete ka të bëjë me propozimin e amendamentit që është dhënë prej koordinatorit nacional dhe shoqërisë civile, ky amendament ka të bëjë me dhunën në familje, kjo është shumë e rëndësishme. Ky sqarim do të duhej të jepej që në fillim, meqë nuk u dha, u hodh në votim, të lutem, siguroni 58 vota, përndryshe ne e ndalim votimin tutje për çdo amendament e çdo ligj, i lus krejt gratë deputete ta ndërprejnë votimin.

KRYETARI: Flora Brovina dhe po e përfundojmë, ju lutem, mos, se jeni duke e maltretuar seancën. Në bazë të respektit po ia japim fjalën Florës, zonja deputete bëju thirrje deputetëve që ta votojnë.

FLORA BROVINA: Faleminderit, kryetar!

I kam dy vërejtje gjatë këtij votimi, kryetar, ju kisha lutur të më dëgjoni, i kam dy vërejtje për këto votime: e para, amendamenti i secilit anëtar të komisionit dhe kryetarja jep amendamente, është një përvojë shumë e gabueshme, sepse në të ardhmen secili kryetar dhe secili anëtar i komisionit do të bëjë amendamente, e jo komisioni si një trup punues dhe si tërësi.

E dyta, Grupi i Grave përbëhet nga 40 gra dhe në qoftë se e kanë dhënë një amendament, atëherë kanë diskutuar. Komisioni edhe një herë po tregon s'e ka shqyrtuar si duhet, ka mundur ta thërrasë përfaqësuesen e Grupit të Grave dhe ta zgjidhë këtë çështje. Prandaj, kujtoj që duhet ta votojmë.

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm pak, Hajdar, tri herë gati u kthyem, po vetëm është mospuna e komisionit tuaj që e vë në lajthitje krejt Kuvendin e Republikës së Kosovës, e në fund nuk e dimë cili është qëndrimi. Hajdar Beqa, Sami Kurteshi, Albulena Haxhiu fjalën e kanë, s'kam çka bëj, po insistojnë.

HAJDAR BEQA: Kryetar!

Nëse më lejohet, e kemi udhëhequr Grupin Punues, e kam kërkuar fjalën prej fillimit të bëhet sqarimi, kanë marrë pjesë të gjithë aktorët, kanë marrë pjesë edhe Gratë Deputete, edhe Rrjeti i Grave dhe ne kemi propozuar si komision në dakordancë të plotë me të gjithë aktorët që të shkojë varianti i parë, është amendamenti i kompletuar, kurse varianti b nuk e përmban atë esencën çka kanë dashur të propozojnë as Rrjeti i Grave, as Gratë Deputete.

Unë konsideroj që përkrahjen duhet ta marrë, edhe propozoj që të shkojë vetëm varianti a, në këtë rast varianti që është i propozuar nga komisioni, u bë një dakordancë e plotë edhe në Grup Punues, edhe në punëtori, kanë marrë pjesë shumë ekspertë dhe janë pajtuar të gjithë aktorët. Kurse, nëse shkojnë dy variantet, atëherë normalisht që duhet të shkohet edhe një herë ndoshta në lexim të tretë. Unë mendoj që ka kaluar varianti a edhe duhet ecur me procedura tutje. Ne jemi pajtuar me variantin a, dhe e përkrahim variantin a.

KRYETARI: A dëshironi, urdhëroni zonja Haxhiu, pastaj Sami Kurteshi.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Probleme të panevojshme, megjithatë versioni i Komisionit për Legjislacion e ka pasur mbështetjen edhe të organizatave të grave, ashtu më është thënë në Grup Punues, por në qoftë se kjo nuk qëndron, atëherë komisioni duhet ta tërheqë amendamentin, të vlejë vetëm amendamenti

i Grupit të Grave Deputete, pa këtë përkufizimin që nuk lejohet kështu të futet në Projekt-kod, në këtë rast. Jo, jo mund të dakordohemi, domethënë është shumë e gjatë, Arben, është shumë e gjatë, e ke përpara Projekt-kodin, prandaj po them që komisioni duhet të tërhiqet dhe të merret parasysh amendamenti i Grupit të Grave, vetëm pjesa lart, jo edhe kjo “ose përkufizimi sipas Konventës të Këshillit të Evropës”.

**KRYETARI:** Zoti Kurteshi, unë do t’ju bëj një propozim në fund për votim dhe në qoftë se dëshironi, përtoj, po e lexoj. Qenka variacioni b, shumë i mirë, i specifikuar, gratë të cilat e kanë propozuar shumë specifikisht dhe shumë i mirë qenka. Po, edhe unë jam duke i lexuar dy variacionet, në këtë rast variacioni b i Grupit të Grave është më i saktë dhe më i qëndrueshëm, vetëm për korrektësi. Si dëshironi e lexoj, Sami urdhëro!

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam qenë pjesë e grupit punues bashkë me zotin Beqa, realisht në të gjitha takimet e grupit punues kanë marrë pjesë grupet e grave, ku kam qenë unë. Një pjesë për shkak se ka një vëllim të madh, një pjesë të grupeve punuese e kam udhëhequr unë, një pjesë e ka udhëhequr zoti Beqa, po ai ka qenë kryesuesi i grupit punues.

Ne jemi pajtuar për variantin që e ka përkrahur komisioni, tash ju po thoni, s’e di nga cila pozitë, po thoni “ky i grupit të grave qenka më i detajuar e s’di çka”. Në të vërtetë është çështja që në variantin që e ka miratuar komisioni ka punuar grupi punues, bashkë me profesorin Ismet Salihun, ka punuar edhe deputeti Frashër Krasniqi, e ka riformuluar sipas kërkesës së Grupit të Grave. Tash, çka domethënë? Po, mirë kundërshtoni, tash çka domethënë kjo, ne i kemi publikuar këto amendamente, unë si anëtar i grupit punues deri sot asnjëherë nuk e kam marrë asnjë e-mail, asnjë vërejtje nga asnjë grup i grave që e kundërshton në thelb këtë amendamentin e grupit punues. Tash është çështja që neve po na del zonja Haxhiu po thotë “jo”, zonja deputete tjetër po thotë “nuk e di çka u bë”.

Ne i kemi dy variante, është varianti me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Ky i Komisionit FunkSIONAL përmban të gjitha elementet e veprës penale që kemi diskutuar dhe i kanë kërkuar dhe Grupi i Grave, natyrisht nuk e përmban tekstin e Konventës së Këshillit të Evropës në këtë formë, po në atë formë nuk e përmban asnjë Kod Penal. Duhet t’i përmbajë të gjitha elementet e Konventës, por nuk është e thënë të përmbajë fjalë për fjalë edhe citatin e Konventës. Prandaj, nëse paska kundërshtime thelbore, ligjore, ne mundet të mos e votojmë sot, urdhëroni tregoni pse ky variant që ka përkrahur Komisioni FunkSIONAL nuk qenka ai i duhuri dhe cili është elementi ligjor, politik apo gjuhësor që nuk përmbahet në propozimin e Komisionit FunkSIONAL, shumë e lehtë. Nëse ju gjeni ndonjë element, ne jemi këtu dhe po bisedojmë, por jo vetëm të kundërshtohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë kisha pasur dëshirë që deputetët të kthehen në sallë, Albulena po e kërkon fjalën, Memli po ashtu, Hajdari, Albulena Balaj Halimaj, ju burrat a po i lëmë diskutimet, a po i vazhdojmë, unë jua jap fjalën po të doni, Albulena Balaj Halimaj e ka fjalën

ALBULENA BALAJ HALIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Desha ta pyes Albulenën a është me gratë, a është me komisionin? Nuk ka mundësi gratë ta kenë më keq se komisioni, kështu që unë i bashkëngjitem Aidës, ose atë që e tha Aida, nëse nuk përkrahet amendamenti i Grupit të Grave Deputete, as unë, po besoj edhe koleget e mia, nuk do të marrin pjesë sot në asnjë votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka mundësi të vijmë deputetët në sallë, Andin, kërkoj falje, të bëhen 61, votojeni variacionin b, se qenka shumë i saktë, mund edhe ta lexoj? Shkojmë, Korab, por janë edhe pesë vetë para teje, më detyron ta votojmë. Shkojmë në votim! Memli, a shkojmë në votim për variacionin b? Vetëm pak, tani më lejoni vetëm diçka, diskutimi dhe shterimi i këtyre variacioneve, a dhe b është bërë aq shumë, sa çdo gjë që flasim tutje është vetëm keqpërdorim i foltores, vetëm votojeni. Qëndrimi i Grupit të Grave është shumë i qartë, s'e votoni, nuk e votojmë fare ligjin. Shkojmë në votim drejtpërdrejt, në qoftë se dëshironi ta lexoj variacionin b e lexoj, për hir të respektit, kurrëgjë nuk ka konfrontim me të parin, por më mirë të votohet variacioni b.

*(Ndërhyrje)*

Memli Krasniqi, bëhet gati Hajdar Beqa, Muharrem Nitaj, Bekim Haxhiu edhe Korab Sejdiu.

MEMLI KRASNIQI: E kërkoja në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, s'ke nevojë t'ua japësh të gjithëve, vetëm shefave të grupeve mund t'ua japësh fjalën.

I nderuar kryetar,

Nuk ma merr mendja që ti ose dikush tjetër mund të mendoni se e mora fjalën që ta komplikoj punën, po mendoj ta thjeshtësoj, nëse mundem. Varianti a që është votuar, besoj me mirëkuptimin e komisionit, mund të tërhiqet dhe të votohet vetëm propozimi i Grupit të Grave Deputete, por ka nevojë, zoti kryetar, të shpjegohet diçka, se shumë me të drejtë e përmendi Armend Zemaj, kështu qysh e kanë sjellë, ky s'është amendament. Ky është amendament dhe një shpjegim. Duhet specifikuar që po e votojmë amendamentit 45, propozimin b, të Grupit të Grave Deputete që thotë prej pikës 1 kushdo që kryen dhunë e deri ku përfundon me fjalën "Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje". Jo këtë pjesën tjetër, se kjo pjesa tjetër nuk mund të hyjë në ligj, për këtë e mora fjalën, zoti kryetar, që ta specifikoj saktë, të mbetet edhe shënim, edhe po ashtu t'u kërkohej krejt kolegëve ta votojmë këtë, ta mbyllim këtë temë, le të mbetet e Grupit të Grave Deputete, pavarësisht që edhe Hajdar Beqa e të tjerët mund të kenë ndoshta të drejtë, që

qysh e ka sjellë komisioni, ndoshta është edhe më kuptimplotë, por po duam ta lëmë këtë çështje për Grupin e Grave Deputete, jemi 100% të votojmë ashtu qysh e kanë kërkuar.

A bën ta nxjerrim në votim, ta votojmë ashtu qysh e propozova? Faleminderit!

KRYETARI: A po tërhiqen të tjerët, të shkojmë në votim, apo jo? Edhe deputetët duhet të vijnë. Shkojmë në votim, po e shoh reagimin. 60 deputetë, na duhen edhe 2. Deputetë nga bufeja, ju lutem! Jo, jo, tani, ta keni parasysh, varianti, se mora vërejtje prej gjuhëtarëve, varianti i cili merr më shumë vota, kalon. Do të thotë, 57 vota i pati varianti a, tash duhet varianti b t'i ketë 58, 61 të votojnë e 58 për të votuar.

*(Ndërhyrje)*

Shkojmë, ju lutem, deputetë! A ka mundësi vëmendje! Përgatitemi për votim, zonja Sala pastaj do të mbetesh pa votuar për amendamentin që duhet. Varianti b, është një garë interesante në këtë amendament, varianti b, i propozuar nga Grupi i Grave, me një debat shumë të gjerë, votojmë tash!

Ismeti dhe Dardani janë me dorë dy vota, për a? Katër për, do të thotë, ka kaluar me minimum 65 vota, 61 për. Dy abstenime. Do të thotë, ka kaluar varianti b.

E votojmë tekstin e Projekt-kodit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

67 deputetë, 68 kanë votuar, 68 për. Kuvendi e miratoi Kodin nr. 06/L-074, Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

## **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij. Janë gjithsej 28 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL. Zonja kryetare, fjala për ju!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Këtu kam qenë kryesuese e Grupit Punues dhe si siç po e shihni të gjitha amendamentet janë të grupit punues dhe me përkrahje të Komisionit. Kështu që duket se është pak më e lehtë. Faleminderit!

Pra, në emër të Komisionit kërkoj ose ju lus që t'i votoni amendamentet e Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë i kemi 28 amendamente, të gjitha nga Komisioni FunkSIONAL. I votojmë në mënyrë elektronike të gjitha bashkërisht. Votojmë tash! Të gjitha janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

62 vota janë për, 62 deputetë kanë votuar. Për 28 amendamente.

E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar, 60 për, 8 kundër.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL që ta japë arsyetimin e raportit me rekomandime.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Natyrisht nuk është për komunikacion, por është për raportimin e shkeljeve dhe keqpërdorimeve që ndodhin në institucionet publike dhe private.

Këtu janë 90 amendamente, të gjitha me përkrahje të Komisionit. Nuk ka amendamente të deputetëve. Vetëm ju kisha lutur për një gabim teknik, besoj që edhe Administrata është e informuar për këtë. Tek amendamenti 18, besoj që ju kanë informuar zyra e stafit të komisionit. Nga aktualisht qysh është në amendament, të bëhet neni 29, paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohen fjalët: “më së voni deri më 31 janar të vitit vijues”. Pra, amendamenti 18, neni 29, paragrafi 1, fjalët: “31 janar të vitit vijues” zëvendësohen me fjalët “31 dhjetor”. Dhe neni 29, paragrafi 2, në fund të paragrafit shtohen fjalët: “më së voni deri më 31 janar të vitit vijues”. Është vetëm teknik. Unë do ta dorëzoj edhe këtë për të mos pasur probleme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vërejtjen e pati kryetarja e Komisionit. Unë po e fus në votim me vërejtjen, në qoftë se nuk ka asnjë reagim të deputetëve.

Atëherë 1 deri 19, me vërejtjen e kryetares së Komisionit FunkSIONAL, votohen të gjitha bashkërisht me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Do të thotë, në qoftë se për janë të gjitha, futen ndryshimet, ta ritheksoj. Atë që e futi edhe kryetarja e Komisionit FunkSIONAL te amendamenti përkatës. Votojmë tash!

Do të thotë kanë votuar 67 deputetë, 66 janë për, vetëm 1 abstenim. Kanë kaluar të gjitha amendamentet 19, plus teksti i parafrzuar nga kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, i futur në amendamentin 18 si shtesë.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar, 71 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve.

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara, ndërsa Komisioni për Integritime Evropiane nuk e ka përkrahur Projektligjin dhe amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit, zonjën Albulena Haxhiu, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë, janë gjithsej 26 amendamente. Të gjitha janë me përkrahje të Komisionit. Andaj, në emër të komisionit, unë ju ftoj që ta votoni, ndonëse në emër të Grupit Parlamentar ne nuk e përkrahim këtë projektligj.

Ua kemi thënë në sy edhe zyrtarëve të Bashkimit Evropian sa herë që i kemi takuar sidomos për këtë projektligj që ne nuk pajtohemi me këtë koncept të konfiskimit të pasurisë. Ne konsiderojmë që barra e provës duhet të vendoset te personi i dyshuar dhe jo te prokurori dhe jo domosdo duhet të ketë një hetim apo vendim gjyqësor për t'iu konfiskuar dikujt pasuria. Prandaj, në këtë kuptim dhe për shumë arsye të tjera që institucionet e drejtësisë kanë dështuar që t'i ndjekin kriminelët që janë korrumpuar në kurriz të qytetarëve të varfër, ne nuk mund ta përkrahim këtë projektligj.

Ne konsiderojmë që Kosova ka nevojë për ligjin antimafia, për ligjin që e ka propozuar Vetëvendosje dhe që e ka rrëzuar ky Kuvend. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zonja Blerta Deliu-Kodra, në emër të Komisionit për Integritime dhe shkojmë në votim.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Integritet e ka shqyrtuar Projektligjin për kompetencat e zgjeruara të konfiskimit të pasurisë me amendamentet e Komisionit Funkcional dhe ka vendosur që amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional nuk është që kanë qenë në kundërshtim me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Do të thotë nuk kemi pasur atë që e ka fushëveprim Komisioni, nuk ka pasur mospërputhje me direktivat e Bashkimit Evropian. Megjithatë, Komisioni nuk e ka kaluar për shkak se votat në Komision kanë qenë 3 vota për, 3 kundër dhe 2 abstenime. Votat kundër dhe abstenimet kanë qenë vota të opozitës, përderisa votat për kanë qenë vota të pozitës.

KRYETARI: Faleminderit! 26 amendamente, të gjitha nga Komisioni Funkcional. Votojmë në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

70 deputetë kanë votuar, 63 për, 3 kundër, 4 abstenime. Kalojnë 26 amendamente.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar, 63 për, 5 kundër, 4 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-087 për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë.

## **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Kryetare e Komisionit Funkcional, fjala për ju.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Këtë projektligj e ka kryesuar deputeti Sami Kurteshi dhe për shkak të punës që ka bërë duhet ta vlerësojmë. Janë gjithsej 89 amendamente, por situata është e njëjtë. Situata është e njëjtë që ka shumë amendamente që janë dy propozime, ose nuk e kanë përkrahjen e Komisionit. Prandaj besoj që i keni evidentuar ato për të mos i përmendur unë, por në emër të Komisionit pres që të votohen amendamentet që e kanë përkrahjen e Komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë gjithsej 89 amendamente. Unë do t'i lexoj ato të cilat do t'i vë në votim, në mënyrë të përbashkët, në qoftë se kemi dakordim të seancës.

Amendamenti 1 - 8. Pa amendamentin 2. Ta keni parasysh. Prej 10 - 22, prej 24 - 30, prej 32 - 45, 47, prej 50 - 58, prej 60 - 66, prej 68 - 72, prej 74 - 89, janë propozuar nga Komisioni funksional. A i votojmë të gjitha bashkë? S'ka reagim. Përgatitemi për votim në mënyrë elektronike.



I votojmë të gjitha bashkërisht. Tash!

70 deputetë kanë votuar, 68 për, 1 kundër, 1 abstenim. Kanë kaluar të gjitha amendamentet e sipërpërmendura.

Tani amendamenti 2, propozim i deputetes Albulena Haxhiu, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Amendamenti 8, është njëjtë. Kur nuk e lexoj unë, i njëjti tekst. Amendamenti 9, po ashtu. Amendamenti 31. Ju kisha lutur për vëmendje! Edhe amendamenti 31. Shkojnë në votim, janë amendamente të Albulena Haxhiut. Votojmë në mënyrë elektronike tash, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

52 deputetë, 46 për, 4 kundër, 2 abstenime. Por, s'i kemi kaluar.

A ka mundësi edhe një herë amendamentet e sipërpërmendura të votohen bashkërisht. Ju kisha lutur vëmendje deputetëve. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar, 55 për, 5 kundër, 4 abstenime. Kanë kaluar.

Tani qenka vetëm një amendament i Hajdar Beqës. Hajdar Beqa, amendamenti 46, me përkrahje të Komisioni FunkSIONAL. Votojmë tash!

Deputetë të nderuar, ju kisha lutur vëmendje, për arsye se po bllokohet seanca. Edhe një herë e votojmë amendamentin e propozuar nga Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, 46. Votojmë tash!

62 deputetë, 54 për, 4 kundër, 5 abstenim. Kalon ky amendament.

Amendamenti 48. Ju kisha lutur koncentrim. Amendamentet 48 dhe 73, propozim i Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Edhe një herë, 48, 73 dhe 23 janë propozime të Grupit Parlamentar Lista serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

71 deputetë. Ka mobilizim në këtë rast, vetëm e për, 65 kundër, 2 abstenim.

Amendamenti 49, propozim i Komisionit për Buxhet dhe Financa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

69 deputetë, 66 për, 1 kundër, 2 abstenime. Kalon edhe ky amendament.

Amendamenti 59, janë dy propozime. Për amendamentin 59, urdhëro zonja kryetare e Komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ju kisha lutur deputetëve që të kenë vëmendje për shkak se kur ministri i Drejtësisë e ka prezantuar Projektligjin, një prej të arriturave të këtij Projektligji ka qenë pikërisht neni 21 i Projektligjit, ndërsa amendamenti 59, që ka të bëjë me Njësinë për Verifikim Gjyqësor, përkatësisht procedurën e verifikimit të së kaluarës së kandidatit. Po flasim këtu për gjyqtarët. Nuk është veting, sepse vetingu bëhet më ndryshe, por megjithatë ka të bëjë me verifikimin e së kaluarës së kandidatit.

Unë mendoj që në këtë kuptim duhet të përkrahët propozimi B i deputetes Fitore Pacolli, që është version pak më i mirë sesa i Ministrisë dhe të kundërshtohet propozimi i Hajdar Beqës. Nuk e di pse zoti Beqa e ka propozuar amendamentin për ta hequr Njësinë për Verifikim Gjyqësor. Kjo nuk bën të ndodhë, prandaj besoj që edhe ministri do të duhej të jepte kontribut këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, fjala për ju!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit!

E nderuar deputete Haxhiu,

Ky ka qenë prej projektligjeve të para që e kam proceduar në Kuvendin e Kosovës, d.m.th. në fund të vitit të kaluar dhe ndërkohë së bashku edhe me Komisionin Evropian kemi menduar që këtë njësi ta trajtojmë në kuadër të rishikimit funksional.

Për atë arsye e kemi iniciuar edhe përmes zotit Beqa që këtë ta heqim përkohësisht, sepse jemi duke e trajtuar në kuadër të funksionimit të Gjyqësorit, që është shtyllë në kuadër të rishikimit funksional dhe do të jetë pjesë e strategjisë. Mirëpo, sot votohet pra amendamenti pra që është propozuar nga zoti Beqa. Ky është rekomandimi im si ministër në këtë rast. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja kryetare, i kemi dy propozime. Edhe po të dua, nuk mund t'i heq, për arsye se kur reagoje ti, the a pranon ta tërheqësh edhe 22-shin, a cili amendament ishte ai më herët. Po për atë po them, për atë duhet t'i respektojmë. Unë do të jem rixhid, pavarësisht pozicionit politik në respektimin e asaj çka shkruan Rregullorja, na pëlqeu, apo s'na pëlqeu.

Të shkojmë kështu: Amendamenti 59, propozimi A. E votojmë propozimin A, por kishim mundur... i Hajdar Beqës. Faleminderit zonja Haxhiu. Hajdar Beqa, propozimi A, me përkrahjen e Komisionit Funksional. Bëjini votat sa duhet. Votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar, 50 për, 11 kundër, 5 abstenime.

Propozimi i deputetes Fitore Pacolli për të njëjtin amendament, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

69 deputetë kanë votuar, 16 për, 46 kundër, 7 abstenime.

Kalon amendamenti 59, propozim i deputetit Hajdar Beqa, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

E kemi edhe një amendament po ashtu, i cili është i njëjtë, 67. Propozimi i Komisionit FunkSIONAL, varianti A, votojmë tash, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

64 deputetë, 63 për, 1 abstenim, asnjë kundër.

Propozimi i amendamenti 67 nga Lista serbe, propozimi B, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

65 deputetë, 2 për, 61 kundër, 2 abstenime. Kalon varianti A.

Tani jemi në votimin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

70 deputetë, 70 për. Kalon!

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

## **10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr.06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, zonja Albulena Haxhiu, e paraqet raportin me arsyetime.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni e ka shqyrtuar projektligjin. Janë gjithsej vetëm katër amendamente, me përkrahje të Komisionit. Ftoj deputetët që t'i përkrahin këto. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit. Janë gjithsej katër amendamente me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Urdhëro Nait, po e shoh reagimin tënd, pastaj ministri në fund para votimit.

NAIT HASANI: Faleminderit kryetar, por ky projektligj është me dy të tretat e pakicave që duhet të marrin pjesë. Prandaj, është kot të votojmë ne këtu. Këqyreni në grupin e nëntë ligjeve që i keni atje, e shihni më mirë

KRYETARI: Edhe ti ia huqe këtë herë si unë fare me sinjalizues. Kemi të bëjmë me trashëgimi jokulturore. Po de, ia ka huq pak, s'ka gajle.

Shkojmë me katër amendamente. Ministër, a e dëshiron fjalën apo i vëmë në votim!  
Urdhëro! Një sekondë ju kisha lutur, një konsultë e shkurtër.

Bekim urdhëro, vetëm mos krijo polemika.

BEKIM HAXHIU: Jo, kryetar, vetëm po dua t'i përgëzoj kolegët deputetë për azhuritetin që e treguan sonte. Ama unë jam bindur me një fjalë sot, që e kam dëgjuar në të kaluarën që nëse do t'ia japësh një punë për ta komplikuar dikush, jepja dy-tre juristëve, ata e komplikojnë.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, fjala për ju!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Ne sot në seancën e paradites e votuam edhe Ligjin për noterinë. Edhe unë ju propozoj që sot të votohet propozimi i Ministrisë, pra në lidhje me Projektligjin 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë. Të votohen propozimet e Ministrisë, sepse janë në linjë edhe me ligjin që u votua, Ligjin për noterinë, që e votuam në seancën e paradites.

Në të njëjtën kohë, kështu besoj që e ndihmojmë edhe punën, e lehtësojmë edhe punën e gjykatave jashtëzakonisht shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë janë katër amendamente. Votojmë! Urdhëro kryetare e Komisionit edhe një herë.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Është e vërtetë që Kuvendi e votoi në shqyrtim të dytë Projektligjin për noterinë. Por, që këto dy projektligje, edhe për Trashëgiminë në Kosovë, edhe për Procedurën jokontestimore, që janë të ndërlidhura, nuk e prekin Projektligjin për noterinë që e ka votuar sot Kuvendi i Kosovës.

Vetëm ta sqaroj çfarë është çështja. Ministria ka propozuar, për ata që s'janë pjesë e Komisionit, natyrisht është e vështirë ta kuptojnë qëllimin, që për çështjet jokontestimore të trashëgimisë palët të shkojnë vetëm te noterët, por neve na kanë ardhur shumë ankesa të qytetarëve që nuk

qëndrojnë mirë financiarisht, sepse kur shkon te noteri duhet të paguash tarifë shumë më shumë sesa te gjykata.

Prandaj, Komisioni nuk ka bërë asgjë, përveçse ka theksuar dhe amendamentet edhe në procedurën jokontestimore e shpjegojnë këtë që pala t'i ketë dy mundësi, qoftë te noteri, qoftë te gjykata. Pra, të mbetet në diskrecion të palës dhe jo detyrimisht te noteri, sepse kemi raste që nuk qëndrojnë mirë financiarisht, prandaj edhe u drejtohen gjykatave.

Në këtë kuptim, unë i ftoj deputetët e Kuvendit që t'i përkrahin propozimet e komisionit. Pra, ne vetëm kemi thënë që edhe gjykata, edhe noteri, ndërsa vendos pala. Pra, është vetëm për procedurën jokontestimore, se për kontestimore atëherë gjykata natyrisht, nëse ka kontest. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Hajdar Beqa a e dëshirove, edhe ju në Komision, e të shkojmë në votim.

**HAJDAR BEQA:** Faleminderit, kryetar!

Realisht, ne si Komision për Legjislacion e kemi bërë një grup punues me të vetmin qëllim që fryma e tri ligjeve që ka të bëjë edhe në këtë rast për formimin e grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit 2004 për trashëgimi, Projektligjin për noteri dhe Projektligjin për procedura jokontestimore, e kemi bërë të njëjtin grup punues që ta ruajmë frymën. Edhe zonja Haxhiu ka qenë kryetare e grupit punues.

Në këtë rast, Ministria ka të drejtë, se ne sot e kemi votuar Ligjin e noterisë, edhe e rregullon në një formë tjetër këtë çështje dhe unë propozoj për shkak që të mos ta humbim qëllimin e ligjit, në këtë rast të votohet ligji pa amendamentet e Komisionit. Amendamentet e Komisionit të mos e marrin përkrahjen e deputetëve, por ta marrin të sponsorizuesit. Në të kundërtën, unë mendoj që në variantin më të fundit, sponsorizuesi - Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të detyrohet ndoshta ta tërheqë ligjin se i ndërron qëllimi dhe këto tri ligje duhet të jenë në frymë të njëjtë. Andaj kisha kërkuar që të mos votohen amendamentet e Komisionit për Legjislacion. Faleminderit!

**KRYETARI:** Po tash e keni sjellë në Kuvend. Po thirreni me përkrahje të Komisionit Funkcional. Sami, le të flasë edhe kryetarja e Komisionit dhe të shkojmë në votim, sepse është e njëjta çështje, ose ti Sami, njëri. Kryetare, a le të flasë Samiu, apo ti? Urdhëro, fjala për ju.

**ALBULENA HAXHIU:** Veç ta sqaroj. Pjesë e grupit punues ka qenë edhe zoti Beqa. Nuk e di sa herë ka ardhur, se nuk i mbaj mend, se kemi pasur shumë grupe punuese dhe s'është punë e imja, por që as në grup punues e as në Komision nuk i ka kundërshtuar këto propozime, prandaj edhe janë me mbështetje të Komisionit. Në këtë kuptim, edhe një herë, Projektligji për noterinë ka të

bëjë me noterinë, rregullon noterinë dhe nuk merret me këto ndryshime që sot ne jemi duke i trajtuar. Pra, nuk ka kundërthënie ndërmjet këtyre projektligjeve. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Shkojmë në votim për katër amendamente. Votoni si të doni. Vetë është Komisioni FunkSIONAL. Përgatitemi për votim, votojmë katër amendamentet. Votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit. A provojmë edhe një herë? Shkojmë edhe një herë për katër amendamentet, po - jo. Vetëm të dalin 61.

Votojmë katër amendamentet edhe një herë. Votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, 45 janë për, 14 kundër, 6 abstenime.

Jemi duke shkuar për ta votuar tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar, 67 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-008 për plotësim edhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/26 për trashëgiminë në Kosovë.

Keni parasysh, se pati diskutime, kjo trashëgimia, Administrata më thanë për trashëgiminë jokulturore, çfarë lë babai, edhe nëna, prindërit çfarë lënë, ose babagjyshi. Faleminderit!

Kështu që merreni pak, ishte shtjellim kushtetues. Edhe një e kemi:

## **11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-007 për procedurën jokontestimore**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Kryetarja e Komisionit, fjala për ju!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Edhe në këtë projektligj, pra e shpjegova pak më herët se cili është qëllimi i këtyre amendamenteve dhe s'po ndalem, sepse po e shoh që kemi mbetur shumë.

Janë gjithsej 43 amendamente, të gjitha e kanë përkrahjen e Komisionit. Në këtë kuptim në emër të komisionit ftoj që të votohen amendamentet e Komisionit për Legjislacion.

KRYETARI: Faleminderit! 43 amendamente, votojmë tash, të gjitha me përkrahje të komisionit funksional.

63 deputetë kanë votuar, 62 për, vetëm 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi ligjin nr. 06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03L-007 për procedurën jokontestimore.

Amendamentet i kemi kaluar, më falni! Shkojmë, tekstin e projektligjit në tërësi. Votojmë tash!

43 amendamente, 62 deputetë kanë votuar, 62 për.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr.06/L-007 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-007 për procedurën jokontestimore.

## **12. Interpelanca e ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Skënder Reçica, sipas kërkesës së deputetit Faton Topalli, mbështetur edhe nga 11 deputetë nga GP i PSD-së, në lidhje me vdekjet dhe lëndimet e punëtorëve në vendin e punës**

Deputeti Faton Topalli e ka paraqitur këtë interpelancë. Nuk është? Dardan, fjala për ju, a dëshironi? Urdhëro, zoti Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryetar!

Unë propozoj që kjo interpelancë të shtyhet, meqë edhe propozuesi nuk është këtu. Kështu që propozoj që të shtyhet interpelanca në javën e ardhshme. Të enjten apo kurdo që të vendosë Kryesia, bashkë me seancën.

KRYETARI: Atëherë, e shtyjmë për një moment të caktuar, pasi vetë propozuesi e tërhoqi.

## **13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione**

Vazhdojmë seancën, ju kisha lutur!

Komisioni Funksional për të Drejtat e Njeriut i ka rekomanduar Kuvendit për mosmiratim këtë projektligj, të cilin e ka shqyrtuar. Zonja kryetare e Komisionit, Albulena Haxhiu, e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Nëse mbahet seanca, atëherë po e mbroj. A po vazhdojmë? Dakord! Atëherë, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar nismë legislative, në këtë rast ka propozuar Projektligjin për peticione.

Unë besoj që është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Republikës së Kosovës që ta përkrahë në parim për disa arsye. E para, për faktin se gjatë gjithë këtyre viteve në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë proceduar shumë peticione, por që për qytetarët ka qenë shumë e vështirë që të dihen procedurat për ta parashtruar një peticion. Prandaj, duke e pasur parasysh këtë, ne e kemi propozuar këtë projektligj i cili e adreson çështjen e peticionit, pra kur qytetarët...

Sekretar, a po ulesh në vend të kryetarit, apo si është puna?

Unë nuk mund të vazhdoj derisa kryetari i Kuvendit të ulet në karrigen e tij, për shkak se kjo nuk është seancë. Unë s'e kam fare problem që të pres. S'ka problem. Faleminderit! Sepse, nuk isha në dijeni a e përfundove seancën, a e mbylle seancën dhe dole, na le neve duke folur, a si është puna.

KRYETARI: Ju kisha lutur, unë nuk ju reagoj asnjëherë çfarëdo lëvizje që bëni. Jemi në vazhdim të seancës, pata një minutë konsultim me kryeministrin. Bile as një minutë.

ALBULENA HAXHIU: Por, kryetari i Kuvendit çohet nga karrigia e lë nënkryetarin, sipas rregullave.

KRYETARI: Të lutem, ju vetë po e shihni se...

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Edhe të kisha lutur që të kërkojsh rend në seancë, sepse jemi duke diskutuar për një projektligj që është shumë i rëndësishëm.

KRYETARI: Po, kisha pasur dëshirë që deputetët, e di që jeni lodhur. Bufeja pasi është prapa të vazhdojmë me punimet e seancës. Të lutem, vazhdo!

ALBULENA HAXHIU: Atëherë, faleminderit!

Pra, siç isha duke diskutuar, ky projektligj e adreson çështjen e peticionit. Ka gjithsej 24 nene dhe të gjitha këto nene kanë të bëjnë me procedurat për rregullimin e formës, përmbajtjes së peticionit. Po ashtu, një gjë që është tepër e rëndësishme, ka të bëjë me detyrimin për bashkëpunim të institucioneve tjera në raport me Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dhe, sidomos çështja që komisioni përkatës që i shqyrton peticionet nuk ka asnjë të drejtë që ta ndryshojë peticionin, i cili procedohet në Kuvend.

Neve na ka ndodhur shumë herë që komisioni arbitrarisht i ka ndryshuar kërkesat e qytetarëve që i janë drejtuar Kuvendit, prandaj ky projektligj e ndalon këtë. Unë e di që ka disa hapësira që duhet të punohet. Ju e patë që projektligjet që i votuam më herët, diku 80 amendamente i kemi



bërë, në këtë kuptim edhe ky ka nevojë për ndërhyrje, prandaj duke e pasur parasysh rëndësinë e të njëjtit, ne kërkojmë nga deputetët e Kuvendit që ta përkrahin në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar në të njëjtën kohë, e di që jeni lodhur, por kolegë deputetë të jeni më të vëmendshëm.

Do të vazhdoj sipas radhës. Në emër të Komisionit FunkSIONAL, zonja Haxhiu urdhëro, se zonja Duda Balje nuk qenka. Apo zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Po, Komisioni për të Drejtat e Njeriut e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe komisioni rekomandon që të mos votohet ky ligj, për shkak se komisioni e ka një dokument më gjithëpërfshirës për petitionet që ka punuar edhe në mandatin e kaluar me shumë organizata të tjera, dhe kemi vlerësuar që ky propozim i ardhur prej Vetëvendosjes është një plagjiaturë komplet e një organizate tjetër. Dhe, ju rekomandoj që të mos e votojmë, prandaj në emër të komisionit flas komplet për një plagjiaturë të plotë që ne e kemi argumentuar.

Megjithatë, është shumë me rëndësi ta kemi një projektligj për petitionet, por e kemi një dokument gjithëpërfshirës të punuar nga shumë mekanizma të tjerë që na kanë ndihmuar si komision, edhe shumë shpejt komisioni do të dalë me një dokument tjetër.

Prandaj, unë rekomandoj që deputetët të mos e miratojnë këtë projektligj. Është rekomandim i komisionit.

KRYETARI: Replikë, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Ka kohë që zonja Haxhiu po shpif duke e keqpërdorur foltoren e Kuvendit, ndoshta për shkak se konsideron që ka imunitet për shpifjen.

Mos e sill situatën që të paditim për shpifje. Në këtë kuptim, edhe një herë po e sqaroj: Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut është rekomandimi më i kotë që ka ardhur ndonjëherë në Kuvendin e Kosovës. Si mund komisioni përkatës të theksojë që të mos përkrahët një projektligj, sepse ne si komision e kemi një dokument.

Që 10 vjet e keni atë dokument, pse nuk e keni shndërruar në projektligj? Në këtë drejtim, unë edhe njëherë thashë, në emër të grupit parlamentar, ky projektligj ka nevojë për disa ndërhyrje. Jemi të hapur për të marrë parasysh çfarëdo amendamenti, qoftë të deputetit, qoftë të grupit, qoftë të komisionit.

Prandaj, edhe një herë, nëse është e mundshme, ose nëse ka kuorum, atëherë le të hidhet në votim dhe le të përkrahet nga deputetët.

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Teuta Haxhiu, kundër-replikë!

**TEUTA HAXHIU:** Faleminderit, kryetar!

E kemi parë edhe në Facebook, Vetëvendosje po më kërcënon me padi. Kur të duan. Për çka të duan. Jam shumë krenare për shumë çështje që kam ngrehur në Kuvend, dhe kemi edhe vendime të Ministrisë së Arsimit pikërisht për çështjet që unë i kam treguar këtu në Kuvend. Edhe nuk janë shpifje, asnjëherë nuk flas pa argumente.

Prandaj, fola në emër të komisionit. Komisioni refuzon, pra u kërkon të gjithë deputetëve ta refuzojnë një dokument të tillë. Normalisht që me vetëdije të plotë, i kam të gjitha të dhënat, por ne e kemi një dokument shumë më fuqplotë, shumë përmbajtjesor të punuar edhe me shumë organizata të tjera që i kanë ndihmuar komisionin tonë.

Prandaj, është rekomandim i komisionit të mos votohet ky projektligj.

**KRYETARI:** Atëherë, grupet parlamentare. Askush s'e ka kërkuar fjalën. Përfaqësuesi i Qeverisë, jo. Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi në votim. Nuk ka numër të mjaftueshëm të deputetëve. Në momentin kur të kthehen nga bufeja, atëherë i vëmë në votim.

Kalojmë në pikën:

#### **14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma**

Komisioni Funkcional për Bujqësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Mjedisit, zotin Fatmir Matoshi, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

**MINISTRI FATMIR MATOSHI:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për mbrojtjen nga zhurma, të cilin sot po e shqyrtojmë, është hartuar duke u bazuar në standardet e Bashkimit Evropian dhe është në harmoni me konventat dhe Direktivën 2002/49 për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës në mjedis.

Dhe është i hartuar sipas teknikave të reja juridike me një koncept të lehtë për zbatim në sistemin juridik të Republikës së Kosovës. Projektligji përbëhet prej 9 kapitujve dhe ka gjithsej 31 nene. Ky projektligj nuk përmban elemente diskriminuese, si dhe për zbatimin e tij nuk nevojiten mjete të konsiderueshme buxhetore.

Ky projektligj gjithashtu do të synojë të ofrojë një bazë për zhvillimin e masave të komunitetit, për zvogëlimin e zhurmës së imituar nga burimet e mëdha, në veçanti automjetet e transportit rrugor, hekurudhor dhe infrastrukturor, transporti ajror, pajisjet e jashtme, ato të industrisë dhe makineria mobile.

Prandaj, kërkoj që ky projektligj të miratohet, sepse është i domosdoshëm dhe në funksion të zhvillimit dhe të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Zoti Nitaj në emër të komisionit, urdhëroni! Regjia, Muharrem Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar!

Pas dhjetë orëve po kujdesem që të mos e gaboj edhe titullin e ligjit, sepse vërtet në një situatë dhe në një atmosferë zhurmuese në Kuvend është bukur vështirë të funksionojmë.

Sidoqoftë, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional përpara se të nxjerrë në shqyrtim në lexim të parë në Kuvendin e Kosovës, e ka trajtuar Projektligjin për mbrojtje nga zhurma. Ka vlerësuar se ky projektligj i plotëson kushtet e parapara nga neni 54 i Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

Sigurisht se sonte nuk do t'i kemi votat e mjaftueshme për ta kaluar, qoftë edhe në parim, por unë besoj që në mbledhjen e radhës do të kryhet edhe votimi formal. Por, ajo që dua të them është se komisioni ynë, mirëpo edhe grupi parlamentar, meqenëse po flas në të njëjtën kohë edhe në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, do ta japë kontributin e vet dhe do ta analizojë dhe eventualisht do të ndërhyjë e ta amendamentojë në të gjitha pjesët që janë të nevojshme ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka prej grupeve... A po! Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, Andin Hoti!

ANDIN HOTI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah Projektligjin për mbrojtje nga zhurma dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, në emër të Nismës.

MILAIM ZEKA: Në emrin tim, veç unë e kundërshtoj Muharremin dhe ligjin për arsye se ky ligj nuk është në përshtatje me shqiptarët. Unë e kam vajzën dy vjet e gjysmë, beso pa muzikë nuk fle. Kështu që jam kundër këtij ligji për shkak se pa zhurmë, po e shihni edhe në Parlament Muharrem pa zhurmë nuk mund të bëjmë. A është ashtu?

Po, unë do ta përkrah në fund hatri i Muharremit. Pak humor.

KRYETARI: Zoti Nitaj, a dëshirove? Po, replikë se ia ke përmendur emrin. Regjia ose ke problem, ose Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Sa për ta thyer monotoninë Milaim, nuk është fjala për muzikën, është për zhurmën.

KRYETARI: Nait Hasani, po ashtu me zhurma!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Zhurmën e bëjnë deputetët në Kuvend, por ky projektligj ka qenë në Kuvendin e Kosovës. Është amendamentuar. Janë bërë ekspertizat. Janë bërë të gjitha dhe nuk ka kaluar për shkak të zgjedhjeve.

Prandaj, është mirë që komisioni t'i marrë të gjitha ato që janë prezantuar nga projektligji që është i gatshëm dhe ta bëjnë gati me amendamentet, të cilat janë të analizuara edhe me bashkësitë fetare. Janë të analizuara edhe me bizneset. Janë të analizuara po ashtu edhe me kohën dhe ndikimet që i ka zhurma.

Për mua si kryetar i komisionit kur kam qenë, këtë projektligj e kemi trajtuar me komisionin dhe i kemi bërë të gjitha amendamentet. Prandaj, mund të them që është i gatshëm, nëse ministria nuk ka sjellë ndonjë shtesë në këtë projektligj nga ndikimet që i ka pasur atëherë me tash. Edhe këtu është bërë një debat shumë i madh atëherë, por edhe sot në raportin me ezanin, që është trajtuar apo nuk është trajtuar mirë.

Ne e kemi trajtuar këtë çështje dhe e kemi marrë nga Bashkësia Islame e Kosovës modelin e Turqisë që e kanë trajtuar në tri grupe ezanin, me decibilet e rritjes në mëngjes me 45 decibilë. Në drekë e kanë pasur me 65 decibilë dhe në mbrëmje e kanë me 55 decibilë. Kjo do të thotë që zhurma nuk ndikon negativisht. Prandaj, në Kosovë kjo rritje me altoparllant është mbi 120, që do të thotë hyn në grupin ekstrem të zhurmës, dhe kjo ndikon negativisht te fëmijët në mëngjes, te njerëzit e sëmurë dhe natën.

Prandaj, u kërkojmë që këto amendamente të trajtohen dhe të jenë pjesë e projektligjit që do të ndikojë në mbrojtjen e fëmijëve, në mbrojtjen e pleqve dhe në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të paraqitur, as përfaqësues të Qeverisë. Edhe ky projektligj, të nderuar deputetë, do të mbetet në procedurë të votimit në momentin kur t'i kemi 61 deputetë në sallë.

### **15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës**

Komisioni Funkcional për Bujqësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Mjedisit, zotin Fatmir Matoshi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Në mbledhjen e sotme të Kuvendit të Republikës së Kosovës po bëjmë paraqitjen e Projektligjit për infrastrukturën kombëtare të informacionit hapësinor të Republikës së Kosovës.

Me këtë projektligj mundësohet krijimi, mbledhja, si dhe shkëmbimi i informacioneve të centralizuara me vendet tjera sipas praktikave të Bashkimit Evropian. Bëhet përcaktimi i qartë i përgjegjësive të strukturave qeverisëse në Kosovë, si dhe kompetencave për krijimin, grumbullimin dhe shkëmbimin e informacioneve gjeo-hapësinore në Republikën e Kosovës.

Krijohet mundësia për përcaktim të qartë të kriterëve për krijimin e informacioneve, meta-datave si pjesë së infrastrukturës kombëtare të të dhënave hapësinore për Republikën e Kosovës. Harmonizohet legjislacioni i Kosovës me direktivat e infrastrukturës dhe informacioneve hapësinore për Bashkimin Evropian të rregulluara me Direktivën 2007/2, e që është obligim për vendet e Bashkimit Evropian dhe ato që në të ardhmen pretendojnë anëtarësimin.

Andaj, kërkoj që ky projektligj të mbështet dhe të votohet nga deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Zoti Muharrem Nitaj, fjala për ju, në emër të komisionit.

MUHARREM NITAJ: Edhe në emër të komisionit, edhe në emër të grupit, komisioni e ka shqyrtuar. Vlerësojmë se projektligji i plotëson kriteret, kushtet edhe kërkojmë që të kalojë në seancë plenare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ganimete Musliu, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetar!

Edhe Partia Demokratike e Kosovës, përkatësisht Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës, dhe e mbështet në parim.

Gjithashtu, kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve gjatë amendamentit të këtij projektligji.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë përfaqësues të grupeve parlamentare. Nga Qeveria nuk ka. Edhe ky projektligj do të votohet në momentin kur t'i kemi 61 deputetë në sallë. Është në fazën e votimit.

## **16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës**

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

E ftoj ministrin e Arsimit, në emër të kryeministrit, ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Pasi ky ligj i Zyrës së Kryeministrit, në emër të Qeverisë, kërkoj nga ju të nderuar deputetë që të përkrahët Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa, në emër të komisionit.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin, ka pasur mendime të ndryshme, por ka fituar versionin që të mos miratohet. Rekomandimi nga komisioni është që të mos miratohet.

Kurse në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike e përkrahim këtë projektligj dhe kontributin do ta japim ndërmjet dy leximeve nëpërmjet grupeve punuese.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nuk ka deputetë, përfaqësues të grupeve parlamentare. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Në momentin kur t'i kemi 61 deputetë do të votohet.

Me kaq, të nderuar kolegë deputetë, po e shoh të arsyeshme që për sonte ta përfundojmë këtë seancë, por do t'ju njoftojmë për vazhdimin e seancës. I kemi disa pika të mbetura, të cilat janë në proces të votimit dhe këto të cilat kanë mbetur nga Kryesia e Kuvendit. Faleminderit! Nga kryetari përkatësisht. Nga kryetari i Kuvendit, konkretisht. Natën e mirë, faleminderit për kontributin!

\* \* \*

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*